



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

FAKTORËT E RRISKUT PËR PËRFSHIRJE NË SJELLJE KRIMINALE NË ADOLESHENCË

Eglantina Dervishi*; Ani Beqo**; Blerta Doci**

*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

**Sektori i Çështjeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: egladervishi@gmail.com

Përmbledhje

Objektivi i këtij studimi është prezantimi i një panorame të përgjithshme mbi faktorët e riskut që përcaktohen nga adoleshentët si shkaqe për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale.

Metoda: Kampioni i këtij studimi janë 78 të mitur të cilët kanë vuajtur dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri, referuar të dhënave të marra nga intervistave që hetojnë marrëdhëniet familjare e me bashkëmoshatarët, si dhe nga statistikat e institucioneve ku të miturit kryejnë dënimin. Të dhënat i përkasin periudhës 2014-2015.

Rezultatet: Numri i të miturve të përfshirë në sjellje kriminale është i konsiderueshëm dhe duke iu referuar statistikave, ky numër po vjen në rritje. Duket se disa tregues të lidhur me ambientin familjar dalin si faktorë risku për përfshirjen e adoleshentit në sjellje kriminale. Përveç influencës që faktorët personalë dhe familjarë kanë në kryerjen e sjelljeve kriminale nga adoleshentët, del se ndikimi nga bashkëmoshatarët është një tjetër faktor risku potencial.

Konkluzione: Mosha e adoleshencës duhet parë si një periudhë tepër delikate në të cilën influencat e jashtme ndikojnë fuqishëm në mënyrën se si adoleshenti do të përpiqet të njohë dhe të orientojë vetveten në jetë. Ndikimi i fuqishëm i faktorëve familjarë përgjatë zhvillimit të tij do të shfaqë praninë e tij në mënyrën se si adoleshenti do të pozicionojë veten si i rritur me përgjegjësi karshi mjedisit ku jeton. Influencat e faktorëve familjarë do të ndikojnë nga ana e tyre në mënyrën se si adoleshenti do të përzgjedhë të shfaqet para grupit të bashkëmoshatarëve dhe do të ndikohet prej tyre në përpjekje për të gjetur vetveten dhe rrugën e tij në jetë.

Fjalë çelës: *adoleshent, familje, sjellje kriminale, faktor risku, bashkëmoshatarë.*

RISK FACTORS FOR THE INVOLVEMENT IN CRIMINAL BEHAVIORS IN ADOLESCENCE

Abstract

The objective of this study is to present a general overview of the risk factors that are defined by the youth as causes for their involvement in criminal activities.

Method: The sample of the present study consist of 78 youth who have been sentenced in the Albanian Executive Penitentiary Institutions, regarding data collected by the interviews that instigate within family and peer relationships as well as statistics of the institutions where juvenile serve their sentence. Data refer to the 2014-2015 time extension.

Results: The number of youth involved in criminal behaviors is considerable and referring to the statistics it is progressively increasing. As it seems some indicators related to the family environment are revealed as risk factors for the commitment of juveniles in criminal behavior. Despite the influence of the personal and family factors have in juvenile criminal behavior, the peer influence is another potential risk factor.

Conclusions: Teenage needs to be seen as a very delicate period where the external influences strongly affect the way the adolescent will try to recognize and orient themselves in life. The powerful influence of familiar factors through his or her development will be introduced in the mode how the adolescent will posit themselves as an adult with responsibilities to his living environment. Influences of the familiar factors will affect in their turn the way the adolescents will choose to display himself in front of peers and will be influenced either by them in an effort to find themselves and their path in life.

Key words: *adolescent, family, criminal behavior, risk factor, peers.*

Hyrje

Përfshirja e të miturve në akte kriminale është një fenomen i njohur për shoqëritë moderne dhe sigurisht, as vendi ynë nuk mund të bëjë përjashtim. Fenomeni i përfshirjes së adoleshentëve në moshë të re në sjellje kriminale ka shqetësuar shoqërinë tonë, duke u nisur nga një rritje e këtij numri, sidomos në vitet e fundit.

Në këtë kuadër, është me rëndësi të sqarohen fillimisht kufijtë moshorë për të miturit e përfshirë në aktivitete kriminale, me qëllim evidentimin dhe përcaktimin e grupit të synuar, bazuar në legjislacionin shqiptar. Konkretisht, referuar legjislacionit “fëmijë”, apo “i mitur” konsiderohet personi nën moshën 18 vjeç. Personat nën këtë moshë grupohen në:

- Persona nën moshën 14 vjeç;
- Persona 14-18 vjeç.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kufiri minimal për të pasur përgjegjësi penale është 14 vjeç. Për personat e moshës 14-18 vjeç ligji penal përdor termin “i mitur”. Studimet e realizuara në këtë drejtim tregojnë se sjellja delinkuente të të miturit gjenerohet nga faktorë psiko-socialë të riskut (1) të cilët ndërveprojnë midis tyre. Në përpjekje për të analizuar shkaqet e këtij fenomeni mjaft shqetësues, duket se roli i familjes dhe i bashkëmoshatarëve të ketë një ndikim domethënës për sa u përket sjelljeve kriminale (2). Ky punim synon të prezantojë situatën e të miturve në

konflikt me ligjin, duke u përqendruar kryesisht në faktorët që përbëjnë risk për përfshirjen e të miturve në sjellje kriminale. Në këtë kontekst, target-grup i synuar janë të miturit në konflikt me ligjin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Studimet e kryera në këtë fushë kanë treguar se sjelljet kriminale tek të miturit gjenerohen nga praktikat e papërshtatshme të prindërimit (3), që janë ndër shkaqet dhe parashikuesit më të fuqishëm të delinkuencës. Krahasuar me familjet me fëmijë që nuk shfaqin probleme të sjelljes, në familjet me fëmijë që shfaqin problem të kësaj natyre, mendohet se në mënyrë të paqëllimshme përforcohet sjellja negative e fëmijëve.

Keqtrajtimi, apo abuzimi me fëmijët, zakonisht bashkëshoqërohet me faktorë të tjerë familjarë risku dhe me kryerjen e akteve delinkuente në moshë të re (4). Duke u fokusuar sidomos në marrëdhënien midis abuzimit fizik dhe agresivitetit që shfaqin të miturit, një studim i kryer në këtë kontekst sugjeron se 20% e fëmijëve të abuzuar bëhen delinkuentë përpara moshës adulte.

Të qenit dëshmitarë të dhunës në familje (5) ndikon në rritjen e problemeve të sjelljes sidomos te fëmijët meshkuj. Po ashtu sipas studimeve të kryera në këtë fushë rezulton se në shumë familje ku ushtrohet dhunë ndaj nënave, ushtrohet dhunë njëkohësisht dhe ndaj fëmijëve. Të qenit i abuzuar, apo dëshmitar i dhunës në familje mendohet se prek sjelljen e të miturve dy herë më shumë sesa të qenit vetëm dëshmitar i dhunës (6). Krahasuar me djemtë prindërit e të cilëve kanë qëndruar të martuar, djemtë me prindër të divorcuar mendohet se shfaqin më shumë probleme të sjelljes antisociale dhe jocompliante rreth moshës 10 vjeç. Sipas rezultateve të një studimi të kryer, rreth 45% e prindërve të djemve të mitur me probleme të sjelljes (7); vuajnë nga çrregullimi antisocial i personalitetit (8). Nivele të njëjta janë raportuar për abuzimin me substanca dhe depresionin.

Mendohet se bashkëmoshatarët me sjellje deviante kanë më shumë influencë te të miturit me një histori kriminale, për sa i përket rritjes së numrit dhe ashpërsisë së akteve kriminale (9). Kërkime në këtë fushë kanë sjellë të dhëna që tregojnë se grupet kriminale ushtrojnë një ndikim të konsiderueshëm në sjelljen delinkuente të anëtarëve të tyre duke imponuar konformimin e anëtarëve me normat e grupit (10).

Kërkimet e fundit kanë treguar se të miturit e refuzuar nga bashkëmoshatarët janë shumë herë më të rrezikuar për të shfaqur sjellje antisociale (11) në mënyrë të përsëritur në të ardhmen, krahasuar me fëmijët që nuk kanë qenë të refuzuar.

Me anë të intervistave të realizuara synohet eksplorimi mbi faktorët e riskut që shtyjnë të miturit të përfshihen në sjellje delinkuente.

Metodologjia

Objektivat e studimit fokusohen në eksplorimin e faktorëve të riskut të lidhur në dinamikat familjare dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët.

Kampioni i këtij studimi janë të miturit që vuajnë dënimin në katër Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) në Republikën e Shqipërisë. Ky kampion përbëhet nga 78 të mitur, të cilët janë dënuar për vepra të ndryshme penale. Periudha e mbledhjes së të dhënave i përket viteve 2014-2015. Të miturit në konflikt e ligjin në periudhën e intervistimit ishin të gjithë meshkuj.

Instrumenti i përdorur për të gjeneruar të dhëna për analizë ishte një interviste me të miturit që eksploronte marrëdhënien e tyre dhe ndikimin e mundshëm nga familja dhe bashkëmoshatarët duke u nisur nga perceptimi i të miturve. Intervista zgjaste 15 minuta dhe gjatë saj të miturit u asistuan nga një specialist i sektorit të çështjeve sociale.

Procedurat

Fillimisht institucionet përkatëse u informuan në lidhje me qëllimin dhe procedurat e këtij studimi dhe u mor autorizimi për realizimin e tij. Po ashtu, mbi qëllimet e punimit u informuan edhe të miturit në konflikt me ligjin, të cilët pranuan të përfshiheshin në studim. Përpara intervistës, pjesëmarrësve iu dhanë sqarimet e duhura mbi qëllimin e punimit dhe konfidencialitetin e të dhënave identifikuese. Të miturve që pranuan vullnetarisht të kontribuojnë për realizimin e punimit, iu sigurova konfidencialiteti dhe anonimiteti në lidhje me përgjigjet e tyre.


Rezultate dhe diskutime

Përfshirja e të miturve në sjellje kriminale referuar statistikave të I.E.V.P.–ve për periudhën 2015, në lidhje me gjykimin e tyre nga gjykata me vendim të formës së prerë, rezulton se vetë 20 adoleshentë kanë marrë një masë dënimi. Pjesa tjetër janë në proces gjykimi (referoju tabelës 1).

Tabela 1. Numri i të miturve në I.E.V. Penale, nëntor 2015

Institucioni	Të paraburgosur	Të dënuar
Kavajë	20	20
Vlorë	18	-
Korça	3	-
Lezhë	17	-

Duke iu referuar qëllimit mbi eksplorimin e faktorëve të riskut për sjellje kriminale me fokus familjen (Grafiku 1) dhe bashkëmoshatarët, rezulton se 8% e të miturve kanë pasur një anëtarë të familjes të përfshirë në aktivitet kriminal. Ky faktor mund të ndikojë negativisht tek adoleshentët. Një tjetër element që rezulton nga intervistat me të miturit është fakti se 15% e tyre shprehen që kanë pasur një anëtar të familjes të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë. Në 7% të të miturve rezulton prezenca e një anëtari të familjes që abuzon me alkoolin (lidhur kjo me një baba të alkoolizuar). Mungesa e përkujdesjes gjatë gjithë procesit të rritjes, por specifiku gjatë periudhës së paraadoleshencës dhe adoleshencës së hershme, pohohet nga 8% e të miturve. Familja nuk ka shfaqur interes për përjetimet dhe problemet me të cilat përballeshin mituri. Një tjetër tregues interesant lidhet me mbikëqyrjen e parregullt dhe stilet e prindërimit pa kufij të mirëpërcaktuar që mund të çojnë adoleshentin në konfuzion për sa u përket roleve prindërore dhe në një nivel të rritur ankthi dhe stresi si pasojë e mungesës së strukturës dhe rregullit në kontekstin familjarë, gjë për të cilën adoleshenti ka veçanërisht nevojë përgjatë kësaj faze rritjeje. 8% të të miturve shprehen se në mjedisin familjar kanë qenë shpesh pre e dhunës fizike, seksuale apo emocionale. Ndërsa 10% e tyre deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të përdorimit të dhunës në familje. Rreth 10% e adoleshentëve tregojnë se kanë përjetuar humbjen e një anëtari të familjes. 13% të të miturve u është dashur të marrin përsipër përgjegjësinë që të kujdesen për anëtarët e tjerë të familjes. Dhe rreth 19% e tyre shprehen se u është dashur të përballen me probleme të tjera, si probleme të shëndetit mendor të prindërve, braktisje, divorc.

Grafik 1. Tregues të ambientit familjar të të miturve

Faktori i dytë që u mor në shqyrtim në këtë studim është prania e bashkëmoshatarëve si faktorë rrishtit për përfshirje në sjellje kriminale gjatë adoleshencës. Referuar të dhënave të gjeneruara nga intervistat me të miturit, rezultojnë se rreth 21% e të miturve nuk kanë marrëdhënie sociale me shokë të moshës së tyre, dhe 43% e tyre shoqërohen me bashkëmoshatarë të përfshirë në sjellje kriminale, rreth 26% pohojnë se nuk kanë shoqëri që nuk janë të lidhur me sjellje kriminale. Në lidhje me veprat kriminale rezultojnë se 34% e adoleshentëve kanë kryer veprën penale në grup, dhe se 43% e tyre shprehin se nuk kishin me se të kalonin kohën e lirë, pra një mungesë të aktiviteteve të përshtatshme për të krijuar një rutinë pune për të riun. Pjesa më e madhe e të miturve, 52%, deklaron se kohën e lirë e kalonin në rrugë apo ambiente për të rritur, 24% shprehin se janë përfshirë në veprimtari të rrezikshme herë pas here, dhe së fundi, 43% e tyre referojnë se burimin e të ardhurave duhet ta sigurojnë vetë, pasi nuk i ndihmonte as familja dhe nuk kishin një punë.

Nisur nga kjo panoramë mund të themi se, për sa i përket familjes, si faktorë rrishtit kemi një ndërthurje mjaft interesante faktorësh që e bëjnë tablonë të rëndë dhe kërcënojnë seriozisht zhvillimin normal të adoleshentit. Duke iu referuar studimit tonë, rezultojnë se të rritur në një mjedis pa strukturë dhe rregull, mospasja e vëmendjes dhe përkujdesjes prindërore, përfshirja e një anëtarit të familjes në veprimtari kriminale, të pasurit e një anëtarit të familjes të dënuar, rritja në një mjedis ku ushtrohet dhunë fizike, emocionale dhe seksuale, përballja me një prind të alkoolizuar, të qenit dëshmitarë i dhunës në familje, të mbeturit jetim dhe pasja në ngarkesë e prestatëve të familjes krijojnë një tablo të plotë të faktorëve të rrishtit të lidhur me familjen.

Për sa i përket ndikimit të bashkëmoshatarëve, duket se si faktorë rrishtit për përfshirjen e adoleshentëve në sjellje kriminale, rëndësi kanë faktorët që lidhen me mungesën e marrëdhënieve me shokë të së njëjtës moshë, përfshirja dhe të kaluarit e kohës me shokë të cilët janë të përfshirë në veprimtari kriminale, dhe mospasja e lidhjeve miqësore me adoleshentë jodelinkuent.

Përfundime

Adoleshentët më të rrishtuar për t'u përfshirë në sjellje kriminale gjatë kësaj periudhe, por edhe në vazhdimësi të jetës së tyre, kanë një përzierje faktorësh që e përbëjnë tablonë vërtet serioze. Ndikimin më të madh duket se e kanë faktorët që lidhen me dinamikën familjare. Por lidhja midis një

familje e cila nuk është e pranishme dhe nuk udhëheq adoleshentin për të gjetur rrugën e tij, i japin mundësinë që ndikimi i bashkë-moshatarëve të jetë i madh. Është e rëndësishme të mbikëqyret jeta e adoleshentëve jo me qëllim kontrollin, por mbështetjen dhe orientimin në këtë periudhë të ndryshimeve të mëdha fiziko-psiko-emociale. Roli i familjes është vendimtar në mënyrën se si do të përpiqemi të mbajmë larg krimit adoleshentët.

Referenca

1. Duggan. C, Jones. R, (2017). Managing uncertainty in the clinical prediction of risk of harm: Bringing a Bayesian approach to forensic mental health. *Criminal Behaviour and Mental Health*, Volume 27, Issue 1, 1-7.
2. Greenman. S, Matsuda. M. (2016). From Early Dating Violence To Adult Intimate Partner Violence: Continuity And Sources Of Resilience In Adulthood. *Criminal Behaviour and Mental Health*, Special Issue: Dating Violence, Volume26, Issue4, 293-303.
3. KUHLE. C, WARNER. D, WARNER. T. (2015). Intimate Partner Violence Risk Among Victims Of Youth Violence: Are Early Unions Bad, Beneficial, Or Benign?. *Criminology*, Volume 53, Issue3, 427-456.
4. Bernasco, W., Bruinsma, G. J., Pauwels, L. J., & Weerman, F. M. (2013). Adolescent delinquency and diversity in behavior settings. *Australian & New Zealand Journal of Criminology*, 46, 357-378.
5. Zweig. J, Yahner. J, Dank. M, Lachman.P (2014). Can Johnson's Typology Of Adult Partner Violence Apply To Teen Dating Violence?: *Journal of Marriage and Family*, volume 76, Issue 4, 808-825.
6. Caplan, J. M., & Kennedy, L. W. (2016). *Risk Terrain Modeling: Crime prediction and risk reduction*. Oakland: University of California Press.
7. Henggeler, S. W., Schoenwald, S. K., Borduin, C. M., Rowland, M. D., & Cunningham, P. B. (1998). *Multisystemic treatment of antisocial behavior in children and adolescents*. New York, NY: Guilford Press
8. O'Connell, M. E., Boat, T., & Warner, K. E. (Eds.). (2009). *Preventing mental, emotional, and behavioral disorders among young people: Progress and possibilities*. Washington, DC: National Academies Press.
9. Carpentier, J., Leclerc, B., & Proulx, J. (2011). Juvenile sexual offenders: Correlates on onset, variety and desistance of criminal behavior. *Criminal Justice and Behavior*, 38, 854-873.
10. Deslauriers-Varin, N., & Beauregard, E. (2010). Victims' routine activities and sex offenders' target selection scripts: A latent class analysis. *Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment*, 22, 315-342.
11. Freeman, K. A., Dexter-Mazza, E. T., & Hoffman, K. C. (2005). Comparing personality characteristics of juvenile sex offenders and non-sex offending delinquent peers: A preliminary investigation. *Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment*, 17, 3-12.